Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 22 dhjetor 2011

Lëndët nr. 326/09, 327/09, 328/09, 329/09, dhe 330/09

X.

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 22 dhjetor 2011,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesat e lartpërmendura, të parashtruara në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në pajtim me rregullën 13 § 2 të Rregullores së punës, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesat për lëndët nr.326/09, 327/09, 328/09, 329/09 dhe 330/09 janë paraqitur më 11 nëntor 2009 dhe janë regjistruar më 4 dhjetor 2009.

2. Më 9 shtator 2010 Paneli vendosi t'i bashkojë këto lëndë, në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së Punës së Panelit.

3. Më 2 nëntor 2010, Paneli e njoftoi për lëndët Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), në lidhje me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë. Më 28 shkurt2011 PSSP-ja dha përgjigjen e tij.

II. FAKTET

4. Ankuesi informon Panelin që viktima "A" (lënda nr. 326/09), viktima "B" (lënda nr. 327/09), viktima "C" (lënda nr. 328/09), viktima "D" (lënda nr. 329/09) dhe viktima "E" (lënda nr. 330/09) u vranë nga pjesëtarë të armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ndërmjet 15 dhe 22 qershor 1999.

5. Ankuesi jep detaje të mëtejme që viktima "A", viktima "B", viktima "D" dhe viktima "E", janë marrë me forcë nga shtëpia familjare më 15 qershor 1999 nga pjesëtarë të armatosur të UÇK-së dhe janë sjellë në një hotel. Këto veprime u kryen me dhunë ekstreme fizike, duke përfshirë dhunën ekstreme seksuale. Viktima "A", viktima "B" dhe viktima "E", siç raportohet, u vranë në hotel ndërsa viktima "D" arriti të largohet. Ditën e njëjtë më vonë, viktima "C" gjithashtu ishte kapur nga pjesëtarët e UÇK-së dhe është sjellë në hotelin e njëjtë. Ai pastaj është dërguar nga ai vend në një drejtim të panjohur nga pjesëtarët e UÇK-së, dhe përfundimisht është vrarë. Viktima "D" u vra nga pjesëtarë të armatosur të UÇK-së, në mëngjesin e 22 qershorit 1999, në oborrin e shtëpisë së tij.

6. Ankuesi më tutje qartëson që trupat e viktimës "A", viktimës "B", viktimës "C" dhe viktimës "D", u gjetën pak më vonë në vende të ndryshme në Kosovë. Viktima "E" nuk është parë më pas 15 qershorit 1999 dhe mbetjet e tij mortore nuk janë gjetur kurrë.

7. Ankuesi pohon se ai, ia raportoi të gjitha Zyrës së prokurorit për krime lufte dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. KFOR-i, UNMIK-u dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) u informuan gjithashtu rreth çdo gjëje që kishte ndodhur, por asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë.

8. Ankuesi gjithashtu deklaron që një numër i gjërave të luajtshme me vlerë të madhe që u takonin atij dhe viktimave, para të gatshme dhe stoli u vodhën nga shtëpitë e tyre, gjatë kohës së incidentit të përshkruar apo rreth saj.

9. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë. Në periudhën 9 dhjetor 2008 deri më 30 mars 2009, të gjitha dosjet me lëndë penale të mbajtura nga DD i UNMIK-ut dhe Policia e UNMIK-ut, iu dorëzuan EULEX-it.

III. ANKESAT

10. Ankuesi ankohet për dështimin e pretenduar të UNMIK-ut që të hetojë si duhet vrasjen e viktimës "A", viktimës "B", viktimës "C" dhe viktimës "D", dhe zhdukjen dhe vrasjen e mundshme të viktimës "E", dhe për frikën, dhimbjen mentale dhe vuajtjen që i janë shkaktuar atij nga kjo situatë. Përveç kësaj, ankuesi duket se ankohet për dëmin e shkaktuar material.

11. Paneli konsideron që ankuesi mbështetet në shkeljen e të drejtës për jetë të viktimave të vrara apo zhdukura, e garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në shkeljen e të drejtës së tij për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues, e garantuar me nenin 3 të KEDNJ-së si dhe në shkeljen e së drejtës së tij për mbrojtje të pronës, e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

12. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesave, Paneli duhet së pari të vendosë nëse do ti pranojë ato, duke pasur parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

13. Neni 3.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që Paneli të merret me një çështje vetëm pasi që ta përcaktojë se nuk është qartë e pabazuar.

14. Në komentet e tij, PSSP-ja nuk e kundërshton pranueshmërinë e ankesave.

Shkelja e pretenduar e nenit 2 të KEDNJ-së

15. Ankuesi ankohet, në esencë, për mungesën e një hetimi adekuat penal për zhdukjen dhe vrasjen e mundshme të viktimës "E", dhe vrasjen e viktimave të tjera.

16. Paneli konsideron që ankesat sipas nenit 2 të KEDNJ-së ngritin çështje serioze të fakteve dhe ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon që këto pjesë të ankesave nuk janë qartë të pabazuara në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

17. Nuk është provuar asnjë bazë tjetër për t'i shpallur këto pjesë të ankesave të papranueshme.

Shkelja e pretenduar e nenit 3 të KEDNJ-së

18. Ankuesi ankohet për dhimbjen mentale dhe vuajtjen që i janë shkaktuar atij nga situata që ndërlidhet me zhdukjen dhe vrasjen e mundshme të viktimës"E", dhe vrasjen e viktimave të tjera.

19. Për sa i përket vrasjes së viktimës "A", viktimës "B", viktimës "C" dhe viktimës "D", Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në lidhje me çështjen nëse një anëtar i familjes së personit të vrarë, mund të konsiderohet viktimë e një trajtimi në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së, që e ndalon trajtimin jonjerëzor. Ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut pranon që një anëtar i familjes i personit të zhdukur mund të pretendojë të jetë viktimë e një keqtrajtimi të tillë, sidomos në dritë të paaftësisë gjatë një periudhe të zgjatur kohore të gjejë çfarë i ka ndodhur të afërmit, zakonisht nuk zgjerohet në aplikimin e nenit 3 të KEDNJ-së, për të afërmit e një personi i cili është vrarë në një rast të vdekjes së menjëhershme (shih, p.sh., GJEDNJ, *Bitiyeva dhe X kundër Rusisë*, nr. 57953/00 dhe 37392/03, vendimi i gjykatës, 21 qershor 2007, § 152; GJEDNJ, *Udayeva dhe YusupovakundërRusisë*, nr. 36542/05, vendimi i gjykatës, 21 dhjetor 2010, § 82).

20. Duke zbatuar parimin e njëjtë dhe duke mos pasur asnjë dyshim për vuajtjen e thellë që i është shkaktuar ankuesit nga vdekja e viktimave, Paneli nuk gjen asnjë formë të shkeljes së nenit 3 të KEDNJ-së nga UNMIK-u.

21. Nga kjo rrjedh që pjesët e ankesave në lëndët nr. 326/09, 327/09, 328/09 dhe 329/09 në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 3 të KEDNJ-së, janë qartë të pabazuara në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

22. Për sa i përket viktimës "E", Paneli thekson që nuk ka asnjë dëshmi të verifikueshme që ai është vrarë, siç ka qenë rasti për anëtarët tjerë të familjes. Viktima "E" tani është person i zhdukur. Kështu, Paneli është i mendimit që ankuesi pretendon shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së për sa i përket viktimës "E" (shih sqarimin në § 19 më lart).

23. Paneli konsideron më tutje që kjo pjesë e ankesës në lëndën nr. 330/09 ngrit çështje serioze të fakteve dhe ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon që nuk është qartë e pabazuar në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

24. Nuk është provuar asnjë bazë tjetër për t'i shpallur këto pjesë të ankesave të papranueshme.

Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

25. Për sa i përket dëmit material që pretendohet të ketë pësuar familja e ankuesit, Paneli tanimë konsideron që dëmet dhe shkatërrimi i pronës janë akte të menjëhershme, të cilat nuk shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme (shih PKDNJ, *Lajoviq*, nr. 09/08, vendimi i 16 korrikut 2008, § 7). Paneli thekson që humbja e pronës në rastin aktual pohohet të ketë ndodhur ndërmjet 15 dhe 22 qershor 1999. Nga kjo rrjedh që kjo pjesë e ankesave bie jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

- SHPALL ANKESAT TË PRANUESHME PËR SA I PËRKET TË DREJTËS NË JETË (NENI 2 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT);

- E SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN PËR SA I PËRKET NDALIMIT TË TRAJTIMIT JONJERËZOR DHE DEGRADUES (NENI 3 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT) NË LIDHJE ME ZHDUKJEN E VIKTIMËS "E";

- E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESAVE.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues